VENDIM
Nr. 114, datë 8.7.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR TRAJTIMIN E ANKESAVE TË PARAQITURA NGA KLIENTËT DHE PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE MIDIS TË LICENCUARVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të neneve 16; 20, pika "ë"; neni 24, pika 1 dhe 2 të ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 17, pika "ë"; neni 98, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror" dhe nenit 26 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës __.7.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit të ERE-s, në lidhje me miratimin e "Për miratimin e rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror",

konstatoi se:

- ERE është organi kompetent për hartimin dhe miratimin e kësaj rregulloreje.
- Me vendimin nr. 92, datë 9.6.2016, Bordi i ERE-s ka miratuar "Fillimin e procedurave për miratimin e "Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror"" .

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë "Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror".
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsu-matorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

RREGULLORE
PËR TRAJTIMIN E ANKESAVE TË PARAQITURA NGA KLIENTËT DHE PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE MIDIS TË LICENCUARVE, NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË GAZIT NATYROR

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1.1 Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet dhe procedurat, për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin mes të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror dhe trajtimin e ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

1.2 Gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve dhe ankesave, ERE në zbatim të kësaj rregullore ka për qëllim:

a) të ofrojë zgjidhje të shpejtë për mos-marrëveshjet dhe ankesat mes të licencuarve në sektorin e energjisë dhe klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror;

b) të sigurojë që të drejtat e të gjitha palëve janë respektuar;

c) të kontribuojë në përmbushjen e të gjithë objektivave rregullatorë në sektorin e energjisë elektrike dhe në sektorin e gazit natyror;

d) të sigurojë funksionimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë dhe integrimin e tregut shqiptar në atë rajonal dhe evropian të energjisë.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në:

- ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" neni 20, germa "ë"; neni 24, pika 1 dhe 2;
- ligjin nr. 102/2015, "Për gazin natyror" neni 16, pika 16; neni 17, pika 1, germa "ë"; neni 98, pika 1 dhe 2;
- ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";
- "Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016;
- ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve";
- ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Neni 3

Objekti

Kategoritë e ankesave dhe të mosmarrë-veshjeve, objekt i kësaj rregulloreje janë si më poshtë:

3.1 ERE në zbatim të nenit 24, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nenit 98, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror" ka autoritetin ligjor:

3.1.1 për të trajtuar ankesat e klientëve ndaj të licencuarve në lidhje me shërbimet e ofruara:

3.1.2 për të zgjidhur mosmarrëveshjet mes të licencuarve në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të licencuar.

3.1.3 për të zgjidhur mosmarrëveshjet mes të licencuarit dhe çdo klienti apo përdoruesi të sistemit të shpërndarjes dhe sistemit të transmetimit, me cilësinë e palës së tretë, i cili kërkon akses në rrjet,

3.1.4 Çdo ankesë apo mosmarrëveshje që lidhet me elemente të veprës penale ose për të cilën ka filluar një proces gjyqësor, nuk do të trajtohen nga kjo rregullore.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

4.1 "Ligji i energjisë" nënkuptohet ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike";

4.2 "Ligji i gazit" nënkuptohet ligji nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror";

4.3 "Enti Rregullator i Energjisë" ose "ERE" është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe ligjin "Për sektorin e gazit natyror";

4.4 "I licencuar" është një person i pajisur me licencë për të zhvilluar aktivitet në sektorin e energjisë, në përputhje me dispozitat e ligjit për energjinë dhe ligjit për gazin natyror;

4.5 "Ankues" nënkupton personin fizik/juridik, i cili depoziton një ankesë në ERE për çdo veprim ose mosveprim të një të licencuari, që është në juridiksionin e ERE-s, për aktivitetet e parashikuar në ligjin për energjinë elektrike dhe ligjin për gazin;

4.6 "Palë të treta" nënkupton palë të tjera, të cilat mund të jenë të lidhura me zgjidhjen e mosmarrëveshjes;

4.7 "Mosmarrëveshje" çdo konflikt midis një të licencuari me një ose disa të licencuar të tjerë;

4.8 "Ankesë" çdo kërkesë e parashtruar pranë ERE-s, prej klientëve ndaj të licencuarve, lidhur me shërbimin e ofruar nga i licencuari;

4.9 “Klient” është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike dhe gazit natyror, si dhe çdo subjekt tjetër i gazit natyror që blen gaz natyror;

4.10 “Bordi” është organi vendimmarrës i ERE-s, i emëruar sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për gazin natyror”;

4.11 “Interkonektor” është një linjë transmetimi e ndërtuar nga operatori i sistemit të transmetimit ose një palë e tretë, e cila kalon nëpërmjet kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe të një vendi tjetër dhe lidh sistemet kombëtare të transmetimit të të dyja vendeve;

4.12 “Akses i palës së tretë” është e drejta e të gjithë përdoruesve të sistemit për përdorimin e sistemit të transmetimit, shpërndarjes dhe depozitimit të gazit natyror, bazuar në kushte të përcaktuara e të publikuara, në përputhje me parimet e transparencës e të mosdiskriminimit, kundrejt tarifave të miratuara nga ERE;

4.13 “Linjë interkonjeksioni” është një linjë transmetimi, e cila lidh sistemet e transmetimit ndërmjet dy shteteve.

PJESA E DYTË
ROLI DHE PARIMET E ERE-s NË ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE DHE TRAJTIMIN E ANKESAVE

Neni 5
Roli i ERE-s në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave

5.1 Veprimtaria e ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave është ajo e parashikuar nga legjislacioni në sektorin e energjisë.

5.2 Ky rol i ERE-s lidhet me përcaktimin e termave, kushteve dhe procedurave në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimit të ankesave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në mënyrë të tillë që:

5.2.1 Të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjithë klientëve dhe të licencuarve në sektorin e energjisë, në respekt dhe në përmbushje të të drejtave dhe detyrimeve të tyre në shërbimin e furnizimit me energji elektrike dhe gaz natyror.

5.2.2 Të mbrojë klientët e furnizimit me energji elektrike dhe gaz natyror, përmes procedurës transparente, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimit të ankesave dhe garantimin e furnizimit me energji elektrike dhe gaz natyror

5.2.3 Të zgjidhë ankesat midis klientëve dhe furnizueseve, si dhe midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Neni 6
Parimet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe ankesave

6.1 Parimi i transparencës.

ERE do të bazohet në parimin e transparencës për trajtimin sa më të drejtë të ankesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që nënkupton publikimin e informacionit lidhur me mos-marrëveshjet të cilat ERE i ka shqyrtuar, si dhe arsyetimin për arritjen e zgjidhjes së mos-marrëveshjes.

6.2 Parimi i barazisë

ERE do të bazohet në parimin e barazisë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave, duke siguruar trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjithë klientëve dhe të licencuarve të tregut të energjisë në respekt dhe në përmbushje të të drejtave dhe detyrimeve të tyre në shërbimin e furnizimit me energji elektrike dhe gaz natyror.

6.3 Parimi i konfidencialitetit

6.3.1 Në zbatim të nenit 16, pika 4 të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 16, pika 15, të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, ERE është e detyruar të publikojë vendimet lidhur me mosmarrëveshjet dhe të marrë parasysh detyrimin për të ruajtur konfidencialitetin dhe sekretin

tregtar. Publikimi do të bëhet në faqen e internetit të ERE-s, duke mos përfshirë pjesët që kanë të bëjnë me sekretin tregtar.

6.3.2 Në publikimin e vendimeve të saj, ERE do të mbajë në konsideratë parimin e sekretit tregtar të palëve, konform ligjit "Për shoqëritë tregtare". Megjithatë, ERE nuk do të pranojë domosdoshmërisht si të mirëqena pohimet e palëve se interesat e tyre do të dëmtoheshin nga publikimi i informacioneve të caktuara. ERE do të japë vendime të qarta dhe të arsyetuara për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke treguar procedurën e shqyrtimit të çështjes dhe arsyen pse ka arritur në atë vendim.

6.3.3 Palët duhet të deklarojnë nëse, dhe në çfarë baze, një informacion i caktuar do të klasifikohet si sekret tregtar dhe sensitiv kur ato i ofrojnë informacione ERE-s. Publikimi ose jo i një informacioni të caktuar është një çështje të cilën e vendos ERE.

6.3.4 ERE është e detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e konfidencialitetin për çdo informacion apo dokument të vënë në dispozicion nga klienti, në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", në lidhje me një ankesë të paraqitur nga ky i fundit.

Neni 7
Informimi

7.1 ERE duhet të sigurojë në mënyrë lehtësisht të disponueshme për klientët, të licencuarit dhe palët e tjera të interesuara, informacionin e nevojshëm për kushtet, procedurat dhe afatet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe trajtimit të ankesave.

7.2 Ky informacion duhet të jetë i publikuar në formë elektronike, në një gjuhë të qartë, pa pagesë, në format të aksesueshëm për të gjithë.

PJESA E TRETË
PROCEDURAT PËR TRAJTIMIN E ANKESAVE TË KLIENTËVE NDAJ TË LICENCUARVE

Neni 8
Pranimi dhe regjistrimi i ankesave në ERE

8.1 Çdo klient ka të drejtë të drejtohet me ankesë pranë ERE-s në këto raste:

8.1.1 Në rast se i licencuari, me anë të veprimeve ose mosveprimeve të ndërmarra nga ana e tij, ka shkelur dhe cenuar kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike dhe furnizimit të shërbimit universal, si dhe akteve të tjera që lidhen me furnizimin me energji elektrike dhe gaz natyror, të miratuara nga ERE.

8.1.2 Kur klienti ka përfunduar procedurën e trajtimit të ankesave pranë të licencuarit dhe nuk mbetet i kënaqur nga përgjigjja e dhënë nga i licencuari;

8.1.3 Në rast se ankuesi nuk merr një përgjigje nga i licencuari brenda afatit të parashikuar në rregulloren e të licencuarit "Për trajtimin e ankesave" dhe standardeve të cilësisë së shërbimit të miratuara nga ERE.

Rregullorja "Për trajtimin e ankesave" e të licencuarit do publikohet në një vend të dukshëm pranë çdo përfaqësie të tyre.

8.1.4 Çdo rrethanë tjetër që mund të përbëjë shkak për lindjen e një ankese të klientit ndaj të licencuarve dhe nuk është parashikuar më sipër.

8.2 Çdo ankesë e paraqitur në ERE, regjistrohet në format elektronik apo të shkruar.

8.3 Regjistrimi duhet të përfshijë:

a) Një kod unik identifikues;

b) Datën e paraqitjes së ankesës, identitetin e parashtruesit të ankesës dhe detajet e kontaktit të tij;

c) Numrin i kontratës së furnizimit me energji elektrike apo gaz natyror;

d) Subjektin ndaj të cilit ankohet ankuesi;

e) Objektin e ankesës dhe një përmbledhje të saj;

f) Nëse klienti është ankuar më parë në ERE apo tek i licencuari, për të njëjtin objekt ankimi, për të cilin bëhet ankesa e re;

g) çdo informacion apo dokument tjetër që lidhet me shqyrtimin dhe trajtimin e ankesës.

8.4 ERE në të gjitha rastet do të pranojë një ankesë vetëm në rastet kur ankuesi paraqet informacionin minimal të përcaktuar më sipër.

8.5 Të gjitha komunikimet ndërmjet ERE-s dhe ankuesit lidhur me ankesën, do të regjistrohen duke respektuar kodin unik identifikues.

8.6 Pranimi dhe trajtimi i ankesave të klientëve dhe të të licencuarve nga ERE, do të jetë një shërbim i ofruar pa pagesë.

Neni 9

Trajtimi dhe zgjidhja e ankesave

9.1 Trajtimi dhe zgjidhja e ankesave nga ERE do të konsistojë në hetimin dhe verifikimin e të gjitha rrethanat dhe të dhënat lidhur me ankesën e regjistruar.

9.2 ERE, sipas rastit, do të dërgojë për verifikim ankesën pranë subjektit të ankimuar brenda 15 ditë ve kalendarike.

9.3 I licencuari është i detyruar të kthejë përgjigje për trajtimin e ankesës brenda 10 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së shkresës. Në rast se kërkohet nga i licencuari më tepër kohë për trajtimin e ankesës, ky afat mund të zgjatet me 20 ditë të tjera kalendarike.

9.4 ERE, mund të kërkojë informacion shtesë nga ankuesi ose nga i licencuari ndaj të cilit paraqitet ankesa, brenda 10 ditëve kalendarike pas pranimit të ankesës.

9.5 ERE, pasi të ketë riregjistruar ankesën dhe pasi të ketë filluar trajtimin e saj, mund të vendosë se nuk ka juridiksion mbi çështjen.

9.6 Në çdo fazë të shqyrtimit të ankesës, **nëse e çmon të arsyeshme** ERE, mund të thërrasë palët në seancë dëgjimore. Palëve u jepet një afat jo më pak se 5 ditë kalendarike kohë për t'u paraqitur në seancë dëgjimore. Njoftimi për seancë dëgjimore përfshin çështjet që do të trajtohen në seancë dëgjimore.

9.7 Pas përfundimit të trajtimit të ankesës, ERE duhet të informojë ankuesin dhe të licencuarin ndaj të cilit është paraqitur ankesa, për veprimet e ndërmarra për të zgjidhur ankesën dhe për të shmangur problemin.

9.8 Në rastet kur ankesa rezulton e drejtë, ERE i komunikon të licencuarit, veprimet korrigjuese apo kompensuese, të cilat duhet të ndërmarrë ndaj klientit, në përputhje me "Kushtet e përgjithshme të shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë" dhe "Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë", si dhe "Rregullores për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike".

9.9 Veprimet e kërkuara nga ERE ndaj të licencuarit, për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të klientëve, janë të detyrueshme për të licencuarit, subjekt i ankimimit.

9.10 Afati maksimal i trajtimit dhe i zgjidhjes së ankesave të furnizimit me energji elektrike është 30 ditë kalendarike nga regjistrimi i ankesës. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë të tjera kalendarike, në rastet kur ERE-s i nevojitet informacion shtesë.

9.11 Afati maksimal i trajtimit dhe i zgjidhjes së ankesave të furnizimit me gaz natyror është 30 ditë kalendarike nga regjistrimi i ankesës. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë të tjera kalendarike, në rastet kur ERE-s i nevojitet informacion shtesë.

Neni 10

Komunikimi i vendimit

Vendimi ose çdo veprim i ndërmarrë për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesës, duhet t'i komunikohet ankuesit brenda 5 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit ose veprimit të ndërmarrë.

PJESA E KATËRT

PROCEDURA PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE MES TË LICENCUARVE

Neni 11

Pranimi dhe regjistrimi i mosmarrëveshjeve në ERE

11.1 Çdo i licencuar, ka të drejtë të paraqesë me shkrim, pranë ERE-s, një kërkesë për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje, të lindur mes tij dhe një ose më shumë të licencuari tjetër, në këto raste:

11.1.1 Në rast se nga ana e një tjetër të licencuari, me anë të veprimeve ose mosveprimeve të ndërmarra nga ana e tij, ka shkelur dhe cenuar kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike ose gaz natyror të miratuara nga ERE;

11.1.2 Në rastin kur të licencuarit dhe përdoruesit i refuzohet aksesi në rrjet;

11.1.3 Në rastin kur nuk është arritur marrëveshja për aksesin në rrjet dhe interkonjeksionin;

11.1.4 Çdo rrethanë tjetër që mund të përbëjë shkak për lindjen e një mosmarrëveshjeje midis të licencuarve dhe nuk është parashikuar më sipër.

11.2 Çdo kërkesë e paraqitur në ERE, për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje, duhet të regjistrohet në format elektronik apo të shkruar. Regjistrimi duhet të përfshijë:

a) Një kod unik identifikues;

b) Data e paraqitjes së kërkesës për shqyrtimin e mosmarrëveshjes;

c) Identiteti i parashtruesit të kërkesës dhe detajet e kontaktit të tij;

d) Objekti i kërkesës dhe një përmbledhje e saj;

e) Çdo informacion apo dokument tjetër që lidhet me shqyrtimin dhe trajtimin e ankesës.

11.3 ERE, në të gjitha rastet do të pranojë një kërkesë për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje, vetëm në rastet kur kërkuesi paraqet informacion minimal të përcaktuar më sipër.

11.4 ERE, pasi të ketë pranuar kërkesën për shqyrtimin e mosmarrëveshjes dhe pasi të ketë filluar shqyrtimin e saj, mund të vendosë se nuk ka juridiksion mbi çështjen.

11.5 Të gjitha komunikimet ndërmjet ERE-s dhe të licencuarit lidhur me kërkesën e tij, do të regjistrohen duke respektuar kodin unik identifikues.

11.6 Pranimi dhe trajtimi i kërkesave të të licencuarve, për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje nga ERE, do të jetë një shërbim i ofruar pa pagesë.

Neni 12

Procedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjes

ERE do të zhvillojë procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në këto faza:

12.1 Pranimi i mosmarrëveshjes

12.1.1 ERE e pranon kërkesën me shkrim për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, kërkesë e cila përmban informacionin e kërkuar të përshkruar në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

12.1.2 ERE do të vendosë nëse kërkesa për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është në kompetencën e ERE-s për zgjidhje dhe do të vlerësojë bazën ligjore për shqyrtimin e mosmarrëveshjes.

12.1.3 Afati maksimal për pranimin ose kundërshtimin e kërkesës është 15 ditë kalendarike nga data e depozitimit të njoftimit. Brenda këtij afati kohor, ERE do të kërkojë plotësimin e të gjithë informacionit të nevojshëm.

12.2 Seanca dëgjimore nga ERE

12.2.1 Përpara shprehjes së qëndrimit ose marrjes së vendimit, **nëse e çmon të arsyeshme,** ERE mund të thërrasë palët në seancë dëgjimore. Palëve u jepet një afat jo më pak se 5 ditë kalendarike kohë për t'u paraqitur në seancë dëgjimore. Njoftimi për seancë dëgjimore përfshin çështjet që do të trajtohen nga ERE-s në seancë dëgjimore.

12.2.2 Në seancë, palët në mosmarrëveshje mund të japin argument me gojë ose me shkrim dhe kanë të drejtë të përfaqësohen ligjërisht.

12.2.3 Në përfundim të seancës dëgjimore, ERE do të shprehë qëndrimin e saj, lidhur me mosmarrëveshjen, dhe nëse është e nevojshme, nëpërmjet vendimit të Bordit.

12.2.4 Bordi i ERE mund të shprehet me vendim nëse rrethanat e mosmarrëveshjes janë të njëjta dhe të përsëritura mes të njëjtave palë. Vendimi përfundimtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të miratohet nga Bordi i ERE-s dhe u njoftohet palëve sipas përcaktimeve në "Rregulloren e organizimit të ERE-s", dhe në "Kodin e Procedurave Administrative", të miratuar me ligjin nr. 44/2015.

12.2.5 Vendimi përfundimtar duhet të përmbajë të plota dhe të qarta arsyet për vendimin e Bordit të ERE-s.

12.2.6 ERE do të publikojë në faqen zyrtare të saj versionin publik të vendimit përfundimtar lidhur me mosmarrëveshjet, duke marrë parasysh detyrimin për mospublikimin e sekreteve tregtare të palëve.

12.3 Afati kohor për zgjidhjen e mosmarrë-veshjeve.

12.3.1 Afati maksimal i shqyrtimit dhe i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për furnizimin/ transmetimit me energji elektrike është 45 ditë kalendarike nga regjistrimi i të kërkesës Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë të tjera kalendarike, në rastet kur ERE-s i nevojitet informacion shtesë.

12.3.2 Afati maksimal i shqyrtimit dhe i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të furnizimit dhe transmetimit të gazit natyror është 45 ditë kalendarike nga regjistrimi i kërkesës. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë të tjera, në rastet kur ERE-s i nevojitet informacion shtesë.

Neni 13

Rishikimi i vendimit të bordit të ERE-s

Çdo palë e përfshirë në procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me këtë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. ERE do të shqyrtojë kërkesën në zbatim të parashikimeve të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s".

Neni 14

Publikimi i të dhënave lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave

ERE do të publikojë në faqen zyrtare të internetit, numrin e ankesave dhe mosmarrëveshjeve të paraqitura, objektin e tyre, masat dhe veprimet e ndërmarra për eliminimin e tyre.

PJESA E PESTË

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Ankimimi

Kundër vendimit të Bordit të ERE-s mund të bëhet ankimin në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 16

Rishikimi dhe ndryshimi i rregullave

Kjo rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga ana e Bordit të ERE-s.